



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

---

**V E N D I M**

**PËR CAKTIMIN E VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE TË ZAZ-SË NR. 58, QARKU FIER, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30.06.2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 10.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zëvendëskryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr. 58, Qarku Fier, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

**V Ë R E N**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 1563 prot., datë 20.03.2019, i është drejtuar Prefektit të Qarkut Fier, duke kërkuar paraqitjen e listës së plotë të objekteve brenda territorit të Qarkut Fier që përmbushin kriteret e neneve 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, dhe Udhëzimit të KQZ-së nr. 4, datë 9.04.2015. për caktimin e Vendeve të Numërimit të Votave, për tetë (8) Zonat e Administrimit Zgjedhor.

Prefekti i Qarkut Fier, me shkresën nr. 2449 prot, datë 19.04.2019, i ka paraqitur KQZ-së propozimet për ambiente të cilat mund të shërbejnë si Vende të Numërimit të Votave për secilën nga VNV-të e Qarkut Fier.

Ambienti i propozuar për krijimin e VNV-së për ZAZ-në Nr. 58, Qarku Fier, është:

1. Palestra e Gjimnazit të Ri "Janaq Kilica", Fier me sipërfaqe 400 m<sup>2</sup>;



**Nr. 293 i Vendimit    Data 10.05.2019 e Vendimit    Ora 11:00 e vendimit**

Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr.58, Qarku Fier, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019

Ky ambient ka qenë Vend i Numërimit të Votave për ZAZ-në nr. 58 në zgjedhjet e mëparshme, ndodhet brenda territorit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, plotëson kriteret e parashikuara në nenin 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor, i ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 4, datë 9.04.2015, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për mënyrën e caktimit dhe organizmit të Vendit të Numërimit të Votave, kriteret për caktimin e numrit të grupeve të numërimit për çdo vend të numërimit të votave, përcaktimin e rregullave për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupeve të numërimit".

### **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar:

### **V E N D O S I**

1. Të caktojë Vendin e Numërimit të Votave të ZAZ-së nr. 58, Qarku Fier, në Palestrën e Gjimnazit të Ri "Janaq Kilica", Bashkia Fier.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

**Klement ZGURI Kryetar**

**Denar BIBA Zëvendëskryetar**

**Bledar SKËNDERI Anëtar**

**Edlira JORGAQI Anëtare**

**Rezarta BITRI Anëtare**



**Nr. 293 i Vendimit Data 10.05.2019 e Vendimit Ora 11:00 e vendimit**

Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr.58, Qarku Fier,  
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019